



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-216/1

Në bazë të nenit 14.10 dhe 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesja e Bordit duke ushtruar kompetencat e tyre emergjente konform nenit 13.1 të Statutit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, me datën 3 dhjetor, marrin vendimin e mëposhtëm emergjent.

Arsyetimi për këtë vendim emergjent është se çështja është e natyrës urgjente për të cilën nuk ka qenë e mundur të pritet që të vendoset në një mbledhje të zakonshme të Bordit, apo duke shfrytëzuar procedurën e vendosjes me shkrim sipas nenit 11.6 të Statutit të Bordit.

Më datë 30 maj 2024, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerr Vendimin Përfundimtar me nr. 02/207 përmes së cilit është miratuar shpronësimi për interes publik i pronës së paluajtshme: nr.2313-3, 2314-0, 2315-1 dhe 2775-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 99,507 m² ZK Suharekë, Suharekë dhe investimeve, pjesëve aksesor, druaj të ndryshëm pyjor dhe frutor në parcelat kadastrale nr.2307-2, nr.2313-3, 2314-0, 2315-1 dhe 2775-1 ZK Suharekë, Suharekë, për nevoja të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. AKP me datë 23 tetor 2024 ka përcjellë shkresën nëpërmjet së cilës janë paraqitur të dhënat e llogarisë bankare, dhe shuma aktuale për pagesë EUR 6,942,102.40 dhe ka përcjellë draft marrëveshjen tek MMPHI. Me datë 24 tetor 2024 është ekzekutuar kësti i katërt (4) i Marrëveshjes së parë për shpronësim të pronë parcelës kadastrale nr.2307-2 ZK Suharekë, Suharekë pronë e PRZ014 NSh IGK Ballkani - Njësia Damper, Suharekë për nevoja të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, në përputhje me vendimin përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për shpronësim me numër 04/173 të datës 16 nëntor 2023, e cila shumë është rezervuar në raportin e Shpërndarjes së Përkohshme të Pjesëshme të aprovuar nga BD në muajin maj 2024. Prandaj në mënyrë që të mundë të aprovohet Raporti i shpërndarjes në mbledhjen e BD të datës 20 dhjetor të shpërndahen mjetet tek kreditorët e PRZ014 NSh IGK Ballkani duhet vendimmarrje emergjente nga ana Bordit të Drejtorëve që të Autorizoj Drejtorin Ekzekutiv të AKP-së të nënshkruaj "Marrëveshjen e Mirëkuptimit" me Ministrinë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - MMPHI në bazë të Vendimit Përfundimtar të Qeverisë nr. 02/207 të datës 30 maj 2024 për shpronësimin për interes publik të pronave së paluajtshme: parcela kadastrale nr.2313-3, 2314-0, 2315-1 dhe 2775-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 99,507 m² ZK Suharekë, Suharekë dhe investimeve, pjesëve aksesor, druaj të ndryshëm pyjor dhe frutor në parcelat kadastrale nr.2307-2, nr.2313-3, 2314-0, 2315-1 dhe 2775-1 ZK Suharekë, prona të PRZ014 N.Sh. IGK Ballkani, Suharekë, mbi bazën e së cilës marrëveshje mund të bëhen rezervimet e mjeteve për ankesa.

Menaxhmenti ka dërguar memorandumun sqarues me anekse për këtë çështje me datë 03 dhjetor 2024.

Prandaj, Kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesi duke vepruar së bashku marrin vendimin si më poshtë:

VENDIM

- I. Autorizohet Drejtori Ekzekutiv i AKP-së që të nënshkruaj "Marrëveshjen e Mirëkuptimit" me Ministrinë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - MMPHI për pagesën e shpronësimin të pronave të paluajtshme parcela kadastrale: nr.2313-3, 2314-0, 2315-1 dhe 2775-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 99,507 m² ZK Suharekë, Suharekë dhe investimeve, pjesëve aksesor, druaj të ndryshëm pyjor dhe frutor në parcelat kadastrale nr.2307-2, nr.2313-3, 2314-0, 2315-1 dhe 2775-1 ZK Suharekë, Suharekë në shumën EUR 6,942,102.40 (shuma për pagesë e



përcaktuar nga AKP në shkresën nr. protokoli 4506/6 e datës 24 tetor 2024 nga shuma totale e vlerësimit të pronës) me pesë (5) këste, sipas planit dinamik deri në fund të vitit 2025.

- II. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve dhe Zëvendës Kryesues së Bordit të Drejtorëve;

Kopja e këtij vendimi i dërgohet anëtarëve të Bordit menjëherë pas nënshkrimit.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve të AKP- së



Syzana Dautaj Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve të AKP- së

Prishtinë 04.12.2024



Nr. Ref. BD-216/2

Në bazë të neneve 6.1.1, 6.1.2, 15.1, 15.2.4 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 11.6 të Statutit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, nenet 2 dhe 3 të Rregullores nr.05-2022 - për përgjegjësitë e Bordit dhe Drejtorit Menaxhues të NSH Inex Sharr Planina në Brezovicë, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit përmes procedurës me shkrim sipas nenit 11.6 të Statutit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, me datë 06.12.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Shkarkohen tre (3) anëtarët e mbetur të Bordit të Përkohshëm të Ndërmarrjes Shoqërore Inex Sharr Planina Brezovicë.
- II. Të shpallet konkurs publik i rekrutimit për anëtar të Bordit të përkohshëm të NSH Inex Sharr Planina Brezovicë.
- III. Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi me 29 qershor 2023 përmes vendimit me nr. ref. BD-183/27 kishte emëruar anëtarët e Bordit të Përkohshëm të Ndërmarrjes Shoqërore Inex Sharr Planina Brezovicë. Mandati i Bordit të Përkohshëm të Ndërmarrjes Shoqërore Inex Sharr Planina Brezovicë ka qenë një vit duke filluar nga data e emërimit. Përzgjedhja e Bordit të Përkohshëm të Ndërmarrjes Shoqërore Inex Sharr Planina Brezovicë është bërë përmes procedurës konkurruese përmes shpalljes së konkursit publik. Mandati iu është vazhduar me datë 27 qershor 2024 përmes vendimit nr. Ref. BD-204/66 për një mandat me kohëzgjatje një (1) vit.

Agjencia ka pranuar kërkesën nga z. Fisnik Hyseni për dorëheqje nga Bordi i Përkohshëm Menaxhues i NSH "Inex Sharr Planina Brezovica," e cila është nën administrim të direkt. Po ashtu, para një muaji, ka dhënë dorëheqje të parevokueshme dhe anëtari tjetër i Bordit, z. Shukri Gashi dhe Bordi kishte vetëm 3 nga 5 anëtarët që parashikohen me mandat.

Duke marrë parasysh këto zhvillime dhe sfidat e vazhdueshme me të cilat po përballet ndërmarrja, veçanërisht pas shpalljes për dhënie me qira të asetëve të lira të ndërmarrjes, edhe pse menaxhmenti dhe Bordi i AKP-së kanë zhvilluar takime dhe kanë arritur marrëveshje me Bordin e Përkohshëm për rëndësinë e shpalljes me qira të këtyre asetëve të lira dhe të pa shfrytëzuar për përmirësim të gjendjes financiare të ndërmarrjes, janë pranuar kundërshtime me shkrim nga ana e Bordit të Përkohshëm, pa dhënë arsye të qëndrueshme. Arsyetja e dhënies me qira të këtyre asetëve është se ndërmarrja është duke u përkrahur financiarisht për operim nga ana e AKP-se. Po ashtu, janë vërejtur ngecje të dukshme në zbatimin e projekteve dhe iniciativave për organizimin e duhur të sezonit dimëror, përfshirë:

- Përzgjedhjen e drejtorit të ndërmarrjes,
- Funksionalizimin e sistemit të pagesave dhe kartelave për teleferik dhe skilift,
- Ngecjen në sanimin e kulmit dhe rregullimin e objektit të dhomave në Hotel Molika.
- Funksionalizimin e dy skilifteve, dhe prokurimin për blerjen e pajisjes për shtrimin e borës, që është thelbësore për organizimin e sezonit dimëror në qendrën e skijimit, etj.



Për më tepër, Bordi i Përkohshëm i Ndërmarrjes aktualisht operon me mandat të vazhduar, duke mos treguar përbushjen e mjaftueshme të detyrave të tij.

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin nga Menaxhmenti dhe përmes procedurës me shkrim e paraparë në nenin 11.6 të Statutit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë organeve kompetente brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 6 dhjetor 2024.




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-216/3

Në bazë të nenit 6.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlihen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në, Neneve 10.1.2 dhe 10.1.3 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSH-ve dhe nenit 3.13.1 të Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSH-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohen kërkesa e Qendrës Kinematografike të Kosovës për qira të NSH KINO ABC GENCI në Prishtinë me çmim prej 200.00 Euro në muaj (bruto).**
- II. **Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin nga Menaxhmenti për shqyrtimin e kërkesës së QKK për qira direkte të asetit të NSH Kino ABC Genci.

Pasi që parashtrues i kërkesës është Qendra Kinematografike të Kosovës konform nenit 10 par. 3 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore çmimi i qiradhënies është përcaktuar në bazë të limiteve buxhetore që ka në këtë rast institucioni përkatës dhe duke pasur parasysh faktin që asetit do të shfrytëzohet në shërbim të interesit publik. Në lidhje me këtë, pala ka deklaruar se ka mundësi të paguaj shumën prej 200.00 Euro në muaj (bruto). Agjencia deklaroi se çmimi i propozuar nga ana e Postës së Kosovës është i pranueshëm, dhe bazuar në Rregulloren e lartcekur është në diskrecionin e Bordit të Drejtorëve të vendos nëse do të aprovojë qiranë me çmimin e propozuar nga ana e Postës së Kosovës apo të i ofrojë ndonjë çmim tjetër parashtruesit të kërkesës, duke marrë gjithmonë parasysh interesin publik të kësaj qiradhënie. Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së NSH-ve dhe me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së. Me qëllim të rritjes së të ardhurave të gatshme për NSH-në, këto fonde do të përdoren vetëm për nevojat e NSH-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët. Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtruesin e kërkesës do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha, dhe faktin se Qendra Kinematografike e Kosovës është zotuar se do të fillojë procedurat për shpronësimin e asetit për qëllim të interesit publik, dhe se qëllimi i qiramarrjes së asetit është deri në shpronësim, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 dhjetor 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-216/4

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregullore Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Udhëzuesi për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohen rekomandimet e Menaxhmentit sipas rezultateve të qiradhënies përmes shpalljes publike të datës 25.09.2024 sipas listës së bashkangjitur, respektivisht refuzohet oferta për asetin 152.**
- II. **Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin nga Menaxhmenti për shqyrtimin e rezultateve/çmimeve të ofertimit nga qiradhënia e aseteve përmes shpalljes publike sipas rezultateve të datës 25.09.2024 për asetin 152.

Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore pa marrë parasysh a janë vendosur ndërmarrjet në likuidim apo jo me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së.

Prandaj, dhënia eventuale me qira e aseteve në shtojcë do të shërbente rritjes së të ardhurave të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore (NSH), fonde këto që do të mbahen në mirëbesim për të paguar shpenzimet e likuidimit, pagesat për kreditorëve dhe transferohen eventualisht në Buxhetin e Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë/indirekt i të hyrave nga inkasimi i qirave.

Kontratat e qirasë për asetet e ndërmarrjeve në likuidim nënshkruhen nga Kryesuesit e Autoriteteve të Likuidimit sipas autorizimeve të parapara në Shtojcën e ligjit të AKP-së.


Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 dhjetor 2024




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Lista e Aseteve për qiradhënie të Aseteve të NSH-ve në Likuidim përmes shpalljes publike e dates 25 shtator 2024

Nr	Rajoni	Emri i NSH-së-njësisë	Emri i Ofertesit me ofertën më të lartë	Lloji i asetit	Qiradhënie Mujore/Vjetore	Vendndodhja e Asetit dhe Komuna	Nr i vendimit të DM mbi themelimin e Komisionit për qira	Sa herë është dhënë me qira?	Cmimi më i lartë i qiradhënies paraprake ose Tenderimit të fundit	Sipërfaqja m ²	Cmimi krahasues në bazë të krahasimeve në Raportet e Vlerësimit per m ²	Cmimi krahasues në bazë të krahasimeve në Raportet e Vlerësimit per ar	Cmimi i ofertës më të lartë të pranuar m ²	Cmimi i ofertës më të lartë të pranuar ar	Cmimi i Ofertes më të lartë	Numri i Ofertes
152	Prishtinë	NSH ABC Genci	EDU Invest shpk	Objekt	Qiradhënie e Mujore	Prishtinë	DE 392-2024	3		346	8.17		€ 4.91		€ 1,700.00	1





Nr. Ref. BD-216/5

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenit 5.2 të Statutit të Bordit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Procesverbali i mbledhjes të mbajtur me 27 nëntor 2024 nëpërmjet këtij vendimi aprovet si procesverbal i mbledhjes të Bordit të cekura më lartë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi sipas procedurave procesverbalin e mbledhjes paraprake të mbajtur me 27 nëntor 2024. Dokumenti aprovet në pajtim me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenin 5.2 të Statutit të Bordit të AKP-së.

Duke marrë parasysh këtë, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 24 dhjetor 2024.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-216/6

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të të ngastrave kadastrale: 1846-0 sipërfaqja e përgjithshme 2246 m²; 1848-0 sipërfaqja e përgjithshme 2246 m²; 1852-0 sipërfaqja e përgjithshme 4481 m² ZK Llapnasellë, të gjitha prona të Ndërmarrjes Shoqërore KBI "Kosova Export", me parashtruesin 1ga fshati Carrabeg i Ulët Deçan.
- II. Klasifikimi i pronës të paraqitur në paragrafin I të këtij vendimi është pronë komerciale ndërsa kategoria është parcelë për objekt komercial.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI "Kosova Export me parashtruesin nga fshati Carrabeg i Ulët Deçan.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë lidhur me paragrafet I dhe II të këtij vendimi, Bordi konstatoi se rasti për sipërfaqen tokësore i plotëson kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4.1.3 të Rregullores Nr. 04/2024, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 24 dhjetor 2024

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-216/7

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet inicimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale Nr. 11-2, me sipërfaqe të përgjithshme 5500 m², ZK Lazarevë, pronë e KBI Kosova Eksport – Bujqësia, Komuna Obiliq, me parashtruesin
- II. Klasifikimi i pronës të paraqitur në paragrafin I të këtij vendimi është pronë industriale ndërsa kategoria është parcelë për industri.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin rekomandohet aprovimi i inicimit të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Kosova Eksport – Bujqësia, Komuna Obiliq, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, dhe duke qenë se rasti për sipërfaqen tokësore i plotëson kushtet për inicim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas neneve 4.1.2 dhe 4.1.3 të Rregullores Nr. 04/2024, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në paragrafi I në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 24 dhjetor 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-216/8

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale nr. 410-0 me sipërfaqe të përgjithshme 2524 m², ZK Nekodim, pronë e NSh-së "Pasuria Bujqësore" në Ferizaj me parashtruesit nga Ferizaj.
- II. Klasifikimi i pronës të paraqitur në paragrafin I të këtij vendimi është pronë komerciale ndërsa kategoria është parcelë për objekt komercial
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin rekomandohet aprovimi i iniciimit të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh-së "Pasuria Bujqësore" në Ferizaj me parashtruesit nga Ferizaj.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.


Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, dhe duke qenë se rasti për sipërfaqen tokësore i plotëson kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas neneve 4.1.2 dhe 4.1.3 të Rregullores Nr. 04/2024, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në paragrafi I në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 24 dhjetor 2024




Montor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-216/9

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të ngastrës kadastrale 01498-78 me sipërfaqe të përgjithshme prej 267 m², ZK Prishtinë, Komuna Prishtinë. pronë e KBI Kosova Export "Bujqësia" Fushë Kosovë, me parashtruesin _____ të cilën e përfaqëson _____
- II. Klasifikimi i pronës të paraqitur në paragrafin I të këtij vendimi është pronë industriale ndërsa kategoria është parcelë për industri.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin rekomandohet aprovimi i inicimit të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Kosova Export "Bujqësia" Fushë Kosovë, me parashtruesin _____, të cilën e përfaqëson _____

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.


Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, dhe duke qenë se rasti për sipërfaqen tokësore i plotëson kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas neneve 4.1.1 dhe 4.2 të Rregullores Nr. 04/2024, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në paragrafi I në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:


Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 24 dhjetor 2024




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-216/10

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet inicimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 1205 m² pjesë e parcelës Nr. 1698-6, me sipërfaqe të përgjithshme 3407 m², ZK Llapllasellë, Komuna Graçanicë pronë e KBI Kosova Eksport me parashtruesin _____, me seli në Prishtinë.
- II. Klasifikimi i pronës të paraqitur në paragrafin I të këtij vendimi është pronë komerciale ndërsa kategoria është parcelë për objekt komercial.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin rekomandohet aprovimi i inicimit të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSH KBI Kosova Export “, me parashtruesin _____, me seli në Prishtinë.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, dhe duke qenë se rasti për sipërfaqen tokësore i plotëson kushtet për inicim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4.1.2 të Rregullores Nr. 04/2024, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në paragrafi I në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 24 dhjetor 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-216/11

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, si dhe Ligjit për Tatimin në Pronë Nr. 06/L-005, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet Raporti Përfundimtar për shitjen e ngastrës kadastrale nr. 525-0 me sipërfaqe prej 362 m2, ZK Mitrovicë, pronë e MIT039 NSh "LUX", në vlerën e drejtë prej €144,800, blerësi me përfaqësues**
- II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Përfundimtarë të Divizionit për Shitje Direkte në të cilin rekomandohet miratimi për shitien e pronës së cekur në paragrafin I të këtij vendimi në vlerën e drejtë prej €144,800 me blerës me përfaqësues

Raporti Përfundimtarë i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore. Agjencia ka ndjekur procedurat sipas rregullores në fjalë për shitjen e pronës së NSh-ve përmes procesit të shitjes direkte duke vlerësuar shfrytëzimin aktual që shërben si bazë për klasifikimin e asetëve dhe/ose pjesëve të asetëve të caktuara të tyre për qëllim të arritjes deri tek vlera sipas dispozitave të Rregullores 04/2024.

Pala është pajtuar me vlerën e drejtë të asetit sipas shkresës së datës 03.12.2024 Nr. i protokollit: 5171.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 24 dhjetor 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-216/12

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, si dhe Ligjit për Tatimin në Pronë Nr. 06/L-005, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet Raporti Përfundimtar për shitjen e ngastrës kadastrale nr. 1752-0 me sipërfaqe prej 29 m2, ZK Mitrovicë, pronë e MIT117 NSh Minierat "Kosova Azbest", në vlerën e drejtë prej €9,280 me blerës**
- II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Reportin Përfundimtarë të Divizionit për Shitje Direkte në të cilin rekomandohet miratimi për shitjen e pronës së cekur në paragrafin I të këtij vendimi në në vlerën e drejtë prej €9,280 me blerës

Raporti Përfundimtarë i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore. Agjencia ka ndjekur procedurat sipas rregullores në fjalë për shitjen e pronës së NSh-ve përmes procesit të shitjes direkte duke vlerësuar shfrytëzimin aktual që shërben si bazë për klasifikimin e asetëve dhe/ose pjesëve të asetëve të caktuara të tyre për qëllim të arritjes deri tek vlera sipas dispozitave të Rregullores 04/2024.

ala është pajtuar me vlerën e drejtë të asetit sipas shkresës së datës 03.12.2024 Nr. i protokollit:5182-1.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të paraqeshtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 24 dhjetor 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-216/13

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, si dhe Ligjit për Tatimin në Pronë Nr. 06/L-005, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet Raporti Përfundimtar për shitjen e ngastrës kadastrale nr. 2253-25 me sipërfaqe prej 1073 m2, ZK Vushtrri, pronë e MIT012 NSh "Elan", në vlerën e drejtë prej €68,672 me blerës**
- II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Përfundimtarë të Divizionit për Shitje Direkte në të cilin rekomandohet miratimi për shitjen e pronës së cekur në paragrafin I të këtij vendimi në vlerën e drejtë prej €68,672 me blerës

Raporti Përfundimtarë i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore. Agjencia ka ndjekur procedurat sipas rregullores në fjalë për shitjen e pronës së NSh-ve përmes procesit të shitjes direkte duke vlerësuar shfrytëzimin aktual që shërben si bazë për klasifikimin e asetëve dhe/ose pjesëve të asetëve të caktuara të tyre për qëllim të arritjes deri tek vlera sipas dispozitave të Rregullores 04/2024.

Pala është pajtuar me vlerën e drejtë të asetit sipas shkresës së datës 09.12.2024 Nr. i protokollit: 5263-1.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 24 dhjetor 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-216/14

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, si dhe Ligjit për Tatimin në Pronë Nr. 06/L-005, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet Raporti Përfundimtar për shitjen e ngastrës kadastrale nr. 2448-3 me sipërfaqe prej 458 m², ZK Gjilan, pronë e GJI003 NSh "IDGJ Industria e Duhanit", në vlerën e drejtë prej €43,968 me blerës
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Përfundimtarë të Divizionit për Shitje Direkte në të cilin rekomandohet miratimi për shitjen e pronës së cekur në paragrafin I të këtij vendimi në vlerën e drejtë prej €43,968 me blerës

Raporti Përfundimtarë i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore. Agjencia ka ndjekur procedurat sipas rregullores në fjalë për shitjen e pronës së NSh-ve përmes procesit të shitjes direkte duke vlerësuar shfrytëzimin aktual që shërben si bazë për klasifikimin e asetëve dhe/ose pjesëve të asetëve të caktuara të tyre për qëllim të arritjes deri tek vlera sipas dispozitave të Rregullores 04/2024.

Pala është pajtuar me vlerën e drejtë të asetit sipas shkresës- së datës 09.12.2024 Nr. i protokollit: përmes e-mailit.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 24 dhjetor 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-216/15

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, si dhe Ligjit për Tatimin në Pronë Nr. 06/L-005, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet Raporti Përfundimtar për shitjen e ½ të ngastrës ngastrës kadastrale nr. 160-5 me sipërfaqe prej 59.5 m², ZK Rakosh, pronë e PEJ137 NSh "Korenik", në vlerën e drejtë prej €238 me blerës**
- II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Përfundimtarë të Divizionit për Shitje Direkte në të cilin rekomandohet miratimi për shitjen e pronës së cekur në paragrafin I të këtij vendimi në vlerën e drejtë prej prej €238 me blerës

Raporti Përfundimtarë i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore. Agjencia ka ndjekur procedurat sipas rregullores në fjalë për shitjen e pronës së NSh-ve përmes procesit të shitjes direkte duke vlerësuar shfrytëzimin aktual që shërben si bazë për klasifikimin e asetëve dhe/ose pjesëve të asetëve të caktuara të tyre për qëllim të arritjes deri tek vlera sipas dispozitave të Rregullores 04/2024.

Pala është pajtuar me vlerën e drejtë të asetit sipas shkresës- së datës 12.12.2024 Nr. i protokollit: 5449.


Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 24 dhjetor 2024:




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-216/16

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, si dhe Ligjit për Tatimin në Pronë Nr. 06/L-005 Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet plotësimi i Vendimit BD-204/4; i datës 27 qershor 2024 me dispozitivin: Klasifikimi i shfrytëzimit: Pronë rezidenciale; Kategoria e vlerës: Parcelë për shtëpi familjare, për parashtruesin e kërkesës
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Memorandumin e Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin propozohet klasifikimi dhe kategorizimi i asetëve sipas Vendimit paraprak për iniciimin e shitjes direkte.

Me hyrjen në fuqi të Rregullores nr.04 /2024 për shitjen direkte të asetëve të caktuara të NSh-ve është paraqitur nevoja që për parashtruesit e kërkesave të cilët kanë parashtruar kërkesat para hyrjes në fuqi të rregullores së sipërpërmendur, të plotësohen vendimet e Bordit të Drejtorëve për iniciimin e shitjes direkte në frymën e rregullores nr. 04/2024, përkatësisht nenit 8 dhe nenit 11, në mënyrë që të përcaktohet klasifikimi dhe kategorizimi i pronës për parashtruesit e këtyre kërkesave dhe të plotësohen kushtet për ndërmarrjen e veprimeve në kuptim të nenit 5 dhe nenit 9 të Rregullores në fuqi.

Rregullorja në fuqi kërkon që të përcaktohet klasifikimi i shfrytëzimit dhe kategorizimi i pronës lidhur me kërkesën e parashtruesve në fazën e shqyrtimit dhe rekomandimit nga DSHD, si dhe miratimit të vendimit për iniciimin e shitjes direkte, lidhur me vazhdimin e mëtutjeshëm të procesit të shitjes direkte. Në frymën e këtij arsyetimi, DSHD përmes këtij memorandumi paraqet rastet e mëposhtme për plotësimin e vendimeve paraprake për miratimin e iniciimit të shitjes direkte vetëm në aspektin e shfrytëzimit dhe kategorizimit të pronës, pa afektuar dispozitivin paraprak të këtyre vendimeve.

Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 24 dhjetor 2024



X **Mentor Hyseni**
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-216/17

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, si dhe Ligjit për Tatimin në Pronë Nr. 06/L-005 Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet plotësimi i Vendimit BD-204/5; i datës 27 qershor 2024 me dispozitivin: Klasifikimi i shfrytëzimit: Pronë rezidenciale; Kategoria e vlerës: Parcelë për shtëpi familjare, për parashtruesin e kërkesës
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Memorandumin e Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin propozohet klasifikimi dhe kategorizimi i asetëve sipas Vendimit paraprak për iniciimin e shitjes direkte.

Me hyrjen në fuqi të Rregullores nr. 04/2024 për shitjen direkte të asetëve të caktuara të NSh-ve është paraqitur nevoja që për parashtruesit e kërkesave të cilët kanë parashtruar kërkesat para hyrjes në fuqi të rregullores së sipërpërmendur, të plotësohen vendimet e Bordit të Drejtorëve për iniciimin e shitjes direkte në frymën e rregullores nr. 04/2024, përkatësisht nenit 8 dhe nenit 11, në mënyrë që të përcaktohet klasifikimi dhe kategorizimi i pronës për parashtruesit e këtyre kërkesave dhe të plotësohen kushtet për ndërmarrjen e veprimeve në kuptim të nenit 5 dhe nenit 9 të Rregullores në fuqi.

Rregullorja në fuqi kërkon që të përcaktohet klasifikimi i shfrytëzimit dhe kategorizimi i pronës lidhur me kërkesën e parashtruesve në fazën e shqyrtimit dhe rekomandimit nga DSHD, si dhe miratimit të vendimit për iniciimin e shitjes direkte, lidhur me vazhdimin e mëtutjeshëm të procesit të shitjes direkte. Në frymën e këtij arsyetimi, DSHD përmes këtij memorandumi paraqet rastet e mëposhtme për plotësimin e vendimeve paraprake për miratimin e iniciimit të shitjes direkte vetëm në aspektin e shfrytëzimit dhe kategorizimit të pronës, pa afektuar dispozitivin paraprak të këtyre vendimeve.

Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 24 dhjetor 2024.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-216/18

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, si dhe Ligjit për Tatimin në Pronë Nr. 06/L-005 Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet plotësimi i Vendimit BD-204/6; i datës 27 qershor 2024 me dispozitivin: **Klasifikimi i shfrytëzimit: Pronë rezidenciale; Kategoria e vlerës: Parcelë për shtëpi familjare, për parashtruesin e kërkesës**
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Memorandumin e Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin propozohet klasifikimi dhe kategorizimi i asetëve sipas Vendimit paraprak për iniciimin e shitjes direkte.

Me hyrjen në fuqi të Rregullores nr. 04/2024 për shitjen direkte të asetëve të caktuara të NSh-ve është paraqitur nevoja që për parashtruesit e kërkesave të cilët kanë parashtruar kërkesat para hyrjes në fuqi të rregullores së sipërpërmendur, të plotësohen vendimet e Bordit të Drejtorëve për iniciimin e shitjes direkte në frymën e rregullores nr. 04/2024, përkatësisht nenit 8 dhe nenit 11, në mënyrë që të përcaktohet klasifikimi dhe kategorizimi i pronës për parashtruesit e këtyre kërkesave dhe të plotësohen kushtet për ndërmarrjen e veprimeve në kuptim të nenit 5 dhe nenit 9 të Rregullores në fuqi.

